

NXJERRJA E KUSHTEVE TE REJA TE KONTRATES SE FIDIC

"Kontratat e zgjedhura" per projektet ndertimore dhe infrastrukturore me te rendesishme ne bote jane perditesuar. FIDIC ka nxjerre versione te rishikuara te Librit te Kuq, Librit te Verdhe dhe Librit te Argjente te tij, te njojur nderkombetarisht; duke zevendesuar botimin e tij te njojur Suita e Kontratave FIDIC 1999.

Federata Nderkombetare e Inxhiniereve Konsulente (e njojur me emrin FIDIC, qe eshte akronim i Fédération Internationale Des Ingénieurs-Conseils) ka nxjerre botimin e shumepritur Suita e Kontratave FIDIC 2017 ne konferencen e saj vjetore te perdonuesve qe u zhvillua ne daten 5 dhe 6 Dhjetor 2017 ne Londer. FIDIC ka botuar versione te rishikuara te "Suites se Ylberit" te njojur nderkombetarisht, perkatesisht Libri i Kuq (Punet Ndertimore dhe Inxhinierike), Librin e Verdhe (Impiantet dhe Projektim-Ndertimi) dhe Libri i Argjende (EPC/projekte te gatshme "me celesa ne dore").

Kushtet e kontrates se re FIDIC 2017 zevendesojne botimin e tij te njojur te meparshem Suita e Kontratave FIDIC 1999 qe rregullonte shume nga projektet e rendesishme ne fushen e ndertimit dhe infrastrukture ne nivel boteror per shkak te fleksibilitetit dhe te pershtatshmerise se kontratave te modelit FIDIC ne juridiksione te ndryshme. Si te tilla, kushtet e kontrates se FIDIC aktualisht jane - dhe me siguri do te mbeten - "kontrata e zgjedhur" per projektet ne infrastrukturen nderkombetare dhe procesimit te impianteve, veçanerisht ne Evropen Lindore, Afrike, Lindjen e Mesme dhe Azi.

Kontratat e sapo nxjerra reflektojne nje perditesim te shumepritur dhe nje per gjigje ndaj nevojave te ndryshueshme te industrise se ndertimit. Duke vepruar keshtu, FIDIC ka adoptuar praktikat dhe standarde nderkombetare me te mira ne menyre qe te pasqyroje sfidat me te cilat ballafaqohen kontratat e ndertimit ne nje te ardhme e cila po zhvillohet me ritme te shpejta dhe qe eshte teper e dixhitalizuar.

Perdonuesit e librave te rinj, me te detajuar FIDIC 2017, te cilat tashme do te perbehen nga 21 nene te Kushteve te Pergjithshme te Kontrates dhe jo me nga 20 nene, do te ndeshen me ndryshime te cilat kane ndikim te madh ne krahasim me dispozitat model te vitit 1999. Qellimi kryesor i shumices se ketyre ndryshimeve eshte rritja e qartesise dhe sigurise per te zvogeluar rrezikun e mosmarreveshjeve duke sjelle ne kete menyre rritje te probabilitetit te projekteve te suksesshme. Ne veçanti, modifikimet e meposhtme do te kene ndikimin me te madh tek palet ne marreveshjet nderkombetare te ndertimit bazuar mbi librat FIDIC:

- Neni i meparshem 20 [Padite, Mosmarreveshjet dhe Arbitrazhi] eshte ndare ne **Nenin 20 [Padite e Punedhenesit dhe Kontraktorit]** dhe ne **Nenin 21 [Mosmarreveshjet dhe Arbitrazhi]** per te ndare padite "dite pas dite" te **Paleve nga Mosmarreveshjet e Paleve** dhe per te nxjerre ne pah dallimin ne qasjen kontraktuale; Padite e Punedhenesit nuk jane me pjese e Nenit

20 pasi ato do te trajtohen tani ne Nenin 20 ne te njejten menyre qe jane trajtuar Padite e Kontraktorit;

- **Parografi 3.7 [Percaktimet]** ne Librin e Kuq dhe ne Librin e Verdhe 2017, i cili zevendeson Paragrafin 3.5, detajon **rolin e Inxhinierit ne trajtimin e padive te Paleve** dhe paraqet nje **procedure hap pas hapi** me afatet kohore perkatese;
- **Parografi 8.3 [Programi]** eshte perditesuar me disa **kerkesa shtese** per **programin fillestar** dhe te gjitha **programet e rishikuara** qe duhet ti dorezohen Inxhinierit (sipas Librit te Kuq dhe Librit te Verdhe 2017) ose Punedhenesit (sipas Librit te Argjente 2017) p.sh rruga kritike dhe qdo aktivitet float/ lundrues ose i lidhur, **datat kryesore te dorezimit** per impicantet dhe materialet, dhe qdo **vonesë** dhe **rendi dhe koha e punimeve riparuese** duhet te paraqiten;
- **Parografi 20.2 [Padite per Pagesat dhe/ose EOT]** pershkruan proceduren **hap pas hapi** qe duhet ndjekur ne lidhje me **Padite e Punedhenesit dhe Kontraktorit** per kohen dhe/ose parate. Nese perqjigja fillestare e Inxhinierit (sipas Librit te Kuq dhe Librit te Verdhe 2017) ose e Pales tjeter (sipas Librit te Argjendte) eshte qe Njoftimi per Padine eshte i ndaluar per shkak se i ka kaluar afati sipas dispozites kohore prej 28 ditesh, por Pala kerkuese nuk eshte dakort, Pala kerkuese duhet ti perfshije keto pika ne kerkesen e detajuar ne menyre te plote dhe keto pika qe ngrihen duhet te merren parasysh ne marreveshjen/vendimin;
- **Parografi 21 [Themelimi i DAAB]** parashikon "ngritjen" e nje **Bordi per Shmangien/Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve" (DAAB)** dmth. Bordi emerohet ne fillim te Kontrates dhe eshte ne fuqi gjate kohezgjatjes se kontrates; Per me teper, procedura per marrjen e vendimit te Bordit DAAB dhe moszbatimi i vendimeve te ketij Bordit nga ana e Pales eshte svaruar nga Paragrafin 21.4 [*Marrja e Vendimit te DAAB*] dhe Paragrafi 21.7 [*Moszbatimi i Vendimit te DAAB*].

Megjithate, me siper, reflektohen vetem ndryshimet me te rendesishme. Librat e rind te FIDIC perfshijne ndryshime te metejshme, si ne aspektin e kohezgjatjes dhe ne ate te efekteve. Si ne rastin e Punedhenesit, Kontraktorit ose Inxhinierit, eshte thelbesore qe te gjitha palet te jene plotesisht ne dijeni te ndryshimeve dhe se cfare pasojash sjellin keto ndryshime per ta.

Ne njoftimet tona te ardhshme per klientet ne do te vazhdojme t'ju mbajme te perditesuar per ato çeshtje qe kerkojne vemandje te veçante ne negociatat e kontratave, menaxhimin e kerkesave dhe arbitrimin ne kontratat nderkombetare te ndertimit dhe mosmarreveshjet ne fushen e ndertimit.

Rreth WOLF THEISS

Wolf Theiss eshte nje nga studiot ligjore me ne ze ne tregun e Europes Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CEE/SEE). Ne kemi ndertuar reputacionin tone duke kombinuar ekspertizen e shquar lokale dhe kapacitetet e forta nderkombetare te shoqerise. Zyra jone e pare u hap ne Viene rreth 60 vite me pare. Tashme se bashku formojme nje skuader me mbi 340 avokate me nje larmishmeri backgrounde-sh, qe operojne ne zyrat tona ne 13 shtete ne te gjithe rajonin e CEE/SEE.

Per me teper informacion rreth sherbimeve tona, ju lutemi te kontaktoni:



Thomas Anderl
Partner
thomas.anderl@wolftheiss.com
T: +43 1 51510 5494



Sokol Nako
Partner
sokol.nako@wolftheiss.com
T: + 355 4 2274521

This memorandum has been prepared solely for the purpose of general information and is not a substitute for legal advice.

Therefore, WOLF THEISS accepts no responsibility if – in reliance on the information contained in this memorandum – you act, or fail to act, in any particular way.

If you would like to know more about the topics covered in this memorandum or our services in general, please get in touch with your usual WOLF THEISS contact or with:

Wolf Theiss
Schubertring 6
AT – 1010 Vienna
www.wolftheiss.com